



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - ORŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2193 Më Dt. 16-07-2019
Br. prot. 2193 Dt. 16-07-2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT I PUNËS DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

JANAR- QERSHOR 2019



DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka për qëllim ngritjen dhe modernizimin e tregut në sektorin privat, shërbimet efikase për të gjitha bizneset e komunës sonë, poashtu, ofrimin e kushteve të të bërit biznes me një klimë më të përshtatshme për të gjithë bizneset e komunës së Rahovecit.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2019. Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në bazë të organogramit të organizimit të brendshëm, ka të organizuar këta sektorë:

- Sektori për Ekonomi dhe Zhvillim
- Sektori për Turizëm

Aktivitetet e DEZHT-së

- Largimi i taksave komunale për bizneset prodhuese - në bazë të rregullores: 01.nr.576 . dt 28.02.2017 janë liruar 63% të bizneseve që merren me veprimtari prodhuese, kafiteritë, bizneset e tekstilit dhe të gjitha bodrumet e prodhimit të verërave (familjare) etj.
- Poashtu, jemi në përpilim të një liste të bizneseve që nuk janë aktive dhe që kanë obligime financiare ndaj komunës, t'iu falen borxhet, me ndryshim-plotësim të Rregullores për Taksa dhe Tarifa komunale. Ky veprim po ndodhë gjatë këtij viti.
- Në bazë të një hulumtimi dhe anketimi që ju është bërë bizneseve në Kosovë nga INDEKSI I KONKURUESHMËRISË SË KOMUNAVE, Rahoveci renditet në vendin e dytë bashkë me zyrën tone të Regjistrimit të Bizneseve (ARBK-në), për shërbime të shpejta dhe efikase.
- Rritja e numrit të bizneseve për 5% gjatë katër viteve - në vitin 2019 ka një ngritje të regjistrimit të bizneseve, sipas informatave që i kemi nga zyra e ARBK-së.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Krijimi i Zonës Ekonomike dhe Zonës Turistike - Më datë 22.06.2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike me një hapësirë prej 35,84 ha.
- Ka mbetur të bëhet vetëm licencimi i zonës industriale nga ana e MTI dhe fillimi i investimeve direkte në zonë.
- Ndërsa, në zonën turistike kemi bërë shtigje të reja të ecjes dhe këtë vit pritet të bëhet edhe asfaltimi i rrugës prej Epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit.
- Përkrahja për biznese prodhuese dhe përpunuese të metalit, drurit, plastikës dhe artizanateve- Është bërë thirrja për përkrahjen e tyre.



Zyra për taksa afariste komunale

Tabela e të hyrave për periudhën raportuese

Muajt	Objektivi 2019	Viti 2019
	75.000,00 €	SHUMA
Janar		6.177,00 €
Shkurt		5.525,00 €
Mars		5.765,00 €
Prill		8.682,00 €
Maj		13.425,00 €
Qershor		8,654.00 €
TOTALI		48,228.00 €

Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar - Qershor dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

1	Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar - Qershor 2019	20,501.902 €
2	Të hyrat nga saldoja për periudhën Janar -Qershor 2019	48,868.68€

Zyra e regjistrimit të bizneseve

Për periudhën Janar - Qershor 2019, në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll, biznese të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej lëndët si në tabelën vijuese:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019 (Janar- Qershor)
1	Biznese të reja	62
2	Shuarje Biznesi	23
3	Informatë Biznesi	27
4	Ndryshim Biznesi	39
5	Duplikat Çertifikatë	1
6	Çertifikatë UNMIK-RKS	0
7	Vërtetime	2
8	Konfirmime	4
9	Çertifikatë e Re	487
10	Numri fiskal	0
11	Konsultime + Korigjime	0
Gjithsej		645



Regjistrimi i pasurisë komunale

Punët dhe detyrat e punës janë kryer me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm, në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës nga ana e menaxhmentit.

Gjatë periudhës Janar –Qershor janë bërë këto regjistrime:

Regjistrimet e pasurisë mbi 1000€	Regjistrimet e pasurisë nën 1000€	Regjistrimi i ngastrave të tokës
67	18	165
2,105,253 €	4,460,00€	17,837,700€

Zyra për informacione turistike (ZIT-TIC)

Zyra për Informacione Turistike, në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e përcaktuara për periudhën janar-qershor 2019

- Pritje dhe informim i të gjithë turistëve që kanë frekuentuar komunën tonë gjatë kësaj periudhe;
- Takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me sektorin e turizmit.

Me respekt!

Artan Asllani

Drejtori i DEZHT-së